



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 591/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Risamont” SH.P.K. – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Niti-N” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik”, me numër të prokurimit: 616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KK-PRISHTINË), më datën 10.10.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Risamont” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik”, me numër të prokurimit: 616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KK-PRISHTINË).

II. VËRTETOHET njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik”, me numër të prokurimit: 616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KK-PRISHTINË).

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Risamont" SH.P.K. –Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë me dt:11.04.2019

Hapja e ofertave dt:03.05.2019

Njoftimi me letër standarde për tenderuesin e eliminuar/pa përgjegjshëm dt: 30.05.2019

Kërkesë për rishqyrtim me dt: 05.06.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 05.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "Risamont" SH.P.K. –Prishtinë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 12.09.2019 me nr. 591/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontrate OE "Niti-N"SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik", me numër të prokurimit: 616-19-2038-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KK-PRISHTINË),duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin6, 7, 54, 59, 61 dhe70të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.09.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:30.09.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Pretendimi i parë ankimorë ka të bëjë me përbërjen e komisionit vlerësues. OE ankues pretendon se komisioni vlerësues nuk janë komision profesional ashtu si kërkohet me dispozita e nenit 59 të LPP-së.

OE pretendon se të paktën njëri anëtar i komisionit duhet të jetë profesionit i fushës Inxhinier i Elektros bachelor me 5 vite përvojë pune, drejtimi energjetikë. Sqarojmë se neni 59 i LPP-së nuk e përcakton kualifikime profesionale të anëtarëve të komisionit vlerësues, mirëpo sipas nenit 40.5 të RUOPP-së:

“...Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit... ”.

Dispozita ligjore e cila direkt përcakton se kualifikimet e anëtarëve të jurisë është neni 80 i LPP-së sipas të cilit *“...Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij... ”*, mirëpo kjo dispozitë cakton kushtet.

kur kemi të bëjmë me juri për vlerësim të konkurseve të projektimit, dhe nuk mund të aplikohet në rastin konkret. Bazuar në gjitha ato që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi tjetër ankimorë i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar për 12 pozicione çmime jonormalish të të ulëta dhe se sqarimet e dhëna pranë AK-së nga OE i rekomanduar për kontratë janë të papranueshme sipas nenit 61 të LPP, lidhur me Rregullat për çmim jo normalisht të ulët B57.

Vlerësojmë që në rastin konkret AK.-KK Prishtinë konform nenit 61 të LPP-së lidhur me, nenin 4.4.3, dhe 4.4.5 rregullat për çmim jo normalisht të ulët B57, ka pranuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë të cilat në mënyrë objektive arsyetojnë çmimet e dhëna nga OE në fjalë. Sqarim :

Duke ju referuar vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim të OE: “Risamont”, AK në arsyetim të vendimit për refuzim të kërkesës konstaton se sipas kriterit të për dhënie të kontratës “Çmimi më i ulët me Poentim” në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe OE të ankues ka edhe OE të tjerë të cilët renditen para OE ankues.

Duke u bazuar në vlerësimin e AK-së sipas “vlerësimit me poentim” të AK-KK Prishtinë, në mënyrë të gabuar ka bërë peshimin e çmimeve të OE- ve Pjesëmarrës.

Sipas shkresave të lëndës AK ka zbatuar rregullat sipas kriterit të dhënies së kontratës “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me kriter për dhënie të kontratës “Çmimin më të ulët i poentuar”.

Bazuar në RRUOPP kriteri “Çmimi më i ulët me poentim” me shëmbull konkret duhet të vlerësohet në mënyrën si ne vijim :

SHEMBULL I MIRE:

- Lënda e kontratës: Mirëmbajtja e veturave
- Kriteri për dhënien e kontratës: Çmimi me i ulët me poentim

Kategorit ë	Pesha në bazë të rëndësisë		Çmimi i peshuar	Kompania A		Kompania B		Kompania C	
				Çmimi	Çmimi i peshuar	Çmimi	Çmimi i peshuar	Çmimi	Çmimi i peshuar
1 Çmimi për servisime te rregullta	60	%	Çmimi x 60%	€ 100,00	€ 60,00	€ 80,00	€ 48,00	€ 110,00	€ 66,00
2 Çmimi për mirëmbajtje dhe pjese rezerve	20	%	Çmimi x 20%	€ 100,00	€ 20,00	€ 80,00	€ 16,00	€ 50,00	€ 10,00
3 Çmimi për riparime dhe Ngjyrosje	5	%	Çmimi x 5%	€ 120,00	€ 6,00	€ 200,00	€ 10,00	€ 70,00	€ 3,50
4 Çmimi për pjesët e karrasorise	15	%	Çmimi x 15%	€ 100,00	€ 15,00	€ 150,00	€ 22,50	€ 120,00	€ 18,00
	100%								
Çmimi total (pa peshuar ne baze të rëndësisë dhe frekuencës):				€420,00		€510,00		€350,00	
Çmimi total i peshuar- Kontrata me çmimin me te ulët:				101€		97€		98€	

Fituesi ne baze te kriterit tenderi me çmimin më të ulët: Kompania B.

Arsyeja është se, edhe pse shuma totale e çmimeve për njësi është me i ulëti tek kompania C, por Çmimi i Servisimeve te rregullta (artikulli Nr. 1), do të porositet në të shumtën e rasteve (60%) e që është më i shtrenjti në rastin e kompanisë C.

Shuma totale e çmimeve për njësi është me i larti tek kompania B, megjithatë, artikulli qe nevojitet me se shpeshti (Nr. 1) është më i liri nga kjo kompani prandaj çmimi i përgjithshëm i poentuar është më i ulëti nga kjo Kompani. Fatura do të lëshohet në çdo rast në bazë të sasive reale dhe jo çmimeve te peshuara! Në këtë shembull vetëm kemi peshuar çmimet për njësi ne baze te rëndësisë se tyre!

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet ankimore), ndërsa rekomandon që anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 07.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.10.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankues, përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Rexhepi deklaroj: Pretendimet tona ankimore kanë qenë 5 gjithsejtë duke pasur parasysh ky AP është kthyer në rivlerësim pikërisht për të njëjtat shkelje të procedurave nga ana e Autoritetit Kontraktues referuar vendimit të OSHP-së nr. 305/19 respektivisht 317/19, pavarësisht kësaj Autoriteti Kontraktues ka shpërfillur rekomandimet e OSHP-së dhe të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe në rivlerësim duke bërë trajtim jo të barabartë të OE-ve gjegjësisht duke vepruar me nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu tani në rivlerësim Autoriteti Kontraktues ka dështuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ashtu siç kërkohet në nenin 59 të LPP-së, tani në rivlerësim dispozitat të cilat është dashur të respektohen në përpikëri konform nenit 61 dhe Rregullave B57 nuk janë respektuar apo nuk janë implementuar ashtu siç janë të përcaktuara në nen dhe në rregulla. Për të gjitha janë ofruar fakte dhe argumente për të cilat ky OE tani i propozuar për kontratë herën e parë është eliminuar pikërisht për shkak të çmimeve jo normalisht të ulëta për shkak të kërkesës për sqarim të ushtruar tek Autoriteti Kontraktues tek ky OE tani Autoriteti Kontraktues të njëjtat përgjigje i merr si të bazuara dhe i ka pranuar, në ankesë e kemi cekur se Autoriteti Kontraktues ka pranuar variante të ofruara nga OE mund të cekim një pozicion sa për ilustrim pozicioni nr. 1 është një trup ndriçues që ka vlerën 7 euro ndërsa sqarimi i dhënë nga OE për këtë pozicion është thënë se ekonomiciteti apo llogaria e këtij OE është duke futur edhe pozicionet 13, 25, 6, 26, 29 dhe pozicioni 30 të gjitha këto pozicione që nuk duken të jenë me çmime jo normalisht të ulëta por është e kundërta me çmime abnormalisht të larta. Në raportin e ekspertit ne jemi pajtuar me të por ai ka dhënë përgjigje vetëm për 2 pika. Për pikat tjera nuk ka dhënë përgjigje.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Sallahu deklaroj: Tek pretendimet e OE theksojnë që nuk është zbatuar neni 7 kjo është e pa vërtetë, Autoriteti Kontraktues me datë 27.08.2019 i ka dërguar

letër standarde për tenderues të pa suksesshëm OE ankues "Risamont" SH.P.K. i cili me radhitje të çmimit është i 5-ti për nga çmimi me i ulët ndërsa çmimi i poentuar është i 6-ti me 12 pike, prove është njoftimi i vendimit dhe formula e vlerësimit ne poentim. Po ashtu me datën 16.08.2019 Autoriteti Kontraktues ka kërkuar çmime abnormalisht të ulët për të dhënie të kontratës duke kërkuar analize të çmimeve edhe sqarim si ne vijim citon " Të sqaroni në mënyrë të detajuar çmimin tuaj dhe formimin e tij për këto pozicione, duke përfshirë dëshmitë e çmimeve nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar për furnizim, dëshmitë e prodhimit apo blerjen e mallit apo mënyrën e furnizimit ose favoret tuaja të shërbimit ose nëse kjo nuk mund të arsyetohet çmimin tuaj te deklaroni se cilat janë arsyet apo shkakut që ka paraqit këtë çmim" OE i rekomanduar me datën 20.08.2019 ka kthyer përgjigje profesionale i cili ka qenë ne 12 pozicione me çmimin jo abnormalisht te ulët.

Sqarimi i pare që ka dhen OE për eliminim dallon, ka plotë me sqarimin e dytë që ka dhënë po ashtu theksojmë se OE i rekomanduar është me çmimin me të lirë dhe ka çmimin me poentim me të lartë. Thekson duke ju referuar nenit 59 par.1 i LPP-së theksohet se për të gjitha AP, Autoriteti Kontraktues respektivisht ZKA në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshillues për zyrtarin përgjegjës të prokurimit. Komisioni do të përbëhet me 2 anëtar tjerë të prokurimit, kjo shihet e qarte se çfarë anëtar duhet te caktohen ne komision.

Sa i përket çmimit abnormalisht të ulët ne i kemi theksuar në vendim dhe e kemi marr përgjigjet mirëpo formula nuk e ka dhënë, prove kemi formulën e çmimeve për çmime jo-normalisht të ulët.

Po ashtu e kemi një kërkesë ku është kontestuar formula e poentimit nga eksperti ku ka thënë se nuk është përdor formula e poentimit duke thënë se Autoriteti Kontraktues e ka përdorur tenderin ekonomikisht te favorshëm ne theksojmë" Sipas rregullave të çmimeve abnormale janë 3 kushte minimum duhet të jenë 3 oferta pastaj çdo ofertë që ka 30 % të mesatareve të ofertave, pastaj çdo ofertë që ka 10% çmimin me të ulët se oferta e dytë me radhe ne rastin konkret Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se cilin pozicion me këtë formule dhe të gjitha ata që kanë plotësuar këto kushte janë kërkuar informata sqaruese" sa i përket ekspertizës sipas rregullave të LPP-së në raste ku nuk dihet sasi të indikativë të pozicioneve, kriter më i ulët është çmimi me i ulët i poentuar, sqaroj se rasti i kriterit ekonomikisht me i favorshme për veç çmimeve ka edhe kritere tjera që peshohen psh: garancioni, afatet e liferimit dhe shërbimet pas shitjes.

Ne fund sqaroj se Autoriteti Kontraktues përveç çmimit nuk ka kritere të peshimit andaj ne konsiderojmë se Vendimi i Autoriteti Kontraktues është i ligjshëm dhe duke respektuar vendimin paraprak të OSHP-së poashut duke zbatuar parimin e ligjshmërisë, parimin e ekonomicitetit. OE ankues në pretendimin e tij ka

theksuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar nenin 59 nënparagrafi 2” Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet të Autoritetit Kontraktues dhe një OE në lidhje me një tender të dorëzuar.”

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe i njëjti të ketë për bazë ligjin e LPP-së dhe rekomandimet e OSHP-së.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj:Kërkojmë nga paneli shqyrtues të refuzohet ankesa e OE si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit që ka bërë me përbërjen e komisionit vlerësues, ku OE ankues pretendon se komisioni vlerësues nuk janë komision profesional ashtu si kërkohet me dispozita e nenit 59 të LPP-së. OE pretendon se të paktën njëri anëtar i komisionit duhet të jetë profesionit i fushës Inxhinier i Elektros bachelor me 5 vite përvojë pune, drejtimi energjetikë. Sqarojmë se neni 59 i LPP-së nuk e përcakton kualifikime profesionale të anëtarëve të komisionit vlerësues. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në nenin 40.5 të RUOPP-së thuhet: “Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit... ”.

Dispozita ligjore e cila direkt përcakton se kualifikimet e anëtarëve të jurisë është neni 80 i LPP-së sipas të cilit “...Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij... ”, mirëpo kjo dispozitë cakton kushtet kur kemi të bëjmë me juri për vlerësim të konkurseve të projektimit, dhe nuk mund të aplikohet në rastin konkret. Bazuar në gjitha ato që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar për 12 pozicione çmime jo normalisht të ulëta dhe se sqarimet e dhëna pranë AK-së nga OE i rekomanduar për kontratë janë të papranueshme sipas nenit 61 të LPP, lidhur me Rregullat për çmim jo normalisht të ulët B57.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton në rastin konkret AK.-KK Prishtinë konform nenit 61 të LPP-së lidhur me, nenin 4.4.3, dhe 4.4.5 rregullat për çmim jo normalisht të ulët B57, ka pranuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë të cilat në mënyrë objektive arsyetojnë çmimet e dhëna nga OE në fjalë.

Sqarim :

Duke ju referuar vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim të OE: "Risamont", AK në arsyetim të vendimit për refuzim të kërkesës konstaton se sipas kriterit për dhënie të kontratës "Çmimi më i ulët me Poentim" në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe OE ankues ka edhe OE të tjerë të cilët renditen para OE ankues.

Duke u bazuar në vlerësimin e AK-së sipas "vlerësimit me poentim" konstatojmë se të AK-KK Prishtinë, në mënyrë të gabuar ka bërë peshimin e çmimeve të OE-ve Pjesëmarrës, sepse sipas shkresave të lëndës AK ka zbatuar rregullat sipas kriterit të dhënies së kontratës "Tenderi ekonomikisht më i favorshëm", ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me kriter për dhënie të kontratës "Çmimin më të ulët i poentuar". Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se Bazuar në RRUOPP kriteri "Çmimi më i ulët me poentim" me shembull konkret duhet të vlerësohet në mënyrën si në vijim :

SHEMBULL I MIRE:

- Lënda e kontratës: Mirëmbajtja e veturave
- Kriteri për dhënien e kontratës: Çmimi më i ulët me poentim

Kategoritë	Pesha në bazë të rëndësisë	Çmimi i peshuar	Kompania A		Kompania B		Kompania C	
			Çmimi	Çmimi i peshuar	Çmimi	Çmimi i peshuar	Çmimi	Çmimi i peshuar
1 Çmimi përsërisht terregullta	60 %	Çmimi x 60%	€ 100,00	€ 60,00	€ 80,00	€ 48,00	€ 110,00	€ 66,00
2 Çmimi përmirëmbajtjedhe pjeserezerve	20 %	Çmimi x 20%	€ 100,00	€ 20,00	€ 80,00	€ 16,00	€ 50,00	€ 10,00
3 Çmimi përriparime dheNgjyrosje	5 %	Çmimi x 5%	€ 120,00	€ 6,00	€ 200,00	€ 10,00	€ 70,00	€ 3,50
4 Çmimi përpjesët e karrasorise	15 %	Çmimi x 15%	€ 100,00	€ 15,00	€ 150,00	€ 22,50	€ 120,00	€ 18,00
	100%							
Çmimi total(pa peshuar ne baze të rëndësisë dhe frekuencës):			€420,00		€510,00		€350,00	
Çmimi total i peshuar- Kontrata me çmimin më të ulët:			101€		97€		98€	

Fituesi ne baze te kriterit tenderi me çmimin më të ulët: Kompania B.

Arsyeja është se, edhe pse shuma totale e çmimeve për njësi është me i ulëti tek kompania C, por Çmimi i Servisimeve të rregullta (artikulli Nr. 1), do të porositet në të shumtën e rasteve (60%) e që është më i shtrenjti në rastin e kompanisë C.

Shuma totale e çmimeve për njësi është me i larti tek kompania B, megjithatë, artikulli që nevojitet me se shpeshti (Nr. 1) është më i liri nga kjo kompani prandaj çmimi i përgjithshëm i poentuar është më i ulëti nga kjo Kompani. Fatura do të lëshohet në çdo rast në bazë të sasive reale dhe jo çmimeve të peshuara! Në këtë shembull vetëm kemi peshuar çmimet për njësi në baze të rëndësisë së tyre.

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

Paneli shqyrtues konstaton se eksperti shqyrtues në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se peshimi i çmimeve nga ana e AK-së është bërë në mënyrë të gabuar.

Me gjithë këtë paneli shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të ofertave dhe çmimeve të ofruara nga OE-të pjesëmarrës, e në veçanti pas aplikimit të saktë të kriterit kryesor, çmimi më i ulët me poentim, dhe pas peshimit të saktë të çmimeve, paneli shqyrtues vjen në përfundim se nga të gjithë OE-të ofertues, çmimi më i ulët me poentim prapë del të jetë oferta e OE :“Niti” i cili në këtë rast është OE i rekomanduar për kontratë.

Pas peshimit të çmimeve në mënyrë të saktë OE “Niti” ka çmimin e peshuar më të ulët prej 12€. Ndërsa çmimi i peshuar i OE ankues Risamont është 21€.

Duhet theksuar se pas peshimit të saktë të çmimeve, në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe OE ankues janë edhe tri oferta-çmime të peshuara që janë më të ulëta se çmimi i OE ankues.

Në rastin konkret paneli shqyrtues vlerëson se kthimi i lëndës në rivlerësim dhe aplikimi në mënyrë të duhur i kriterit kryesor nuk do sillte ndryshim në rezultat final të vlerësimit në krahasim me rezultatin që kemi tani, dhe kjo është arsyeja kryesore pse paneli shqyrtues vendosi që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal Prishtinë (KK-PRISHTINË),
- 1x1 OE – "Risamont" SH.P.K. – Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në çeb- faqe të OSHP-së.